

INTERVISTË ME ŞÜKRÜ ZEYNULLAHUN

Prishtinë | Data: 10 nëntor, 2018

Kohëzgjatja: 88 minuta

Të pranishëm:

- Şükrü Zeynullah (I intervistuari)
- Ebru Süleyman (Intervistuesja)
- Donjeta Berisha (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Ebru Süleyman: Axha Şüçri, a mund të prezantohesh, emrin, mbiemrin, vitin dhe vendin e lindjes?

Şükrü Zeynullah: Quhem Şüçri, natyrisht Şükrü. Mbiemri jonë është Zeynullah. Stërgjyshi im quhej Zeynullah, dhe prej atëherë e kemi marrë këtë mbiemër. Jam lindur në Prishtinë. Gjatë fëmijërisë kam kaluar dy-tre vite në Shkup. Babai im do të shkonte në Monopol me detyrë, e kanë marrë prej këtu në Shkup, në fabrikën e duhanit, kemi qëndruar këtu për pak kohë, disa vite. Natyrisht, jemi kthyer përsëri në Prishtinë. Pjesën më të madhe të fëmijërisë e kam kaluar në Prishtinë. Kështu.

Ebru Süleyman: Thatë që stërgjyshi juaj quhej Zeynullah, apo jo?

Şükrü Zeynullah: Stërgjyshi im quhej Zeynullah.

Ebru Süleyman: Si ishte para këtij?

Şükrü Zeynullah: Çfarë...

Ebru Süleyman: Mbiemri.

Şükrü Zeynullah: Mbiemri para këtij... nuk e di. Nuk kishte ndonjë [mbiemër] para këtij.

Ebru Süleyman: Do të thotë nuk kishte mbiemra?

Şükrü Zeynullah: Shiko, {numëron me gishta} babai, gjyshi, stërgjyshi. [Ai ishte] Zeynullahu. Para kësaj... natyrisht, me Zeynullah [sistemi patrilinear i mbiemrave] ka filluar zyrtarisht. Sidoqoftë, ky ka qenë mbiemri ynë që prej atëherë, nuk ka ndryshuar.

Më parë nuk e kemi njohur njëri-tjetrin mirë në Kosovë, le të themi nga Prizreni, Vushtrria, Mitrovica, Gjilani, Peja, jo aq shumë. Por siç mund ta kuptoj këtë... komunikimi është përmirësuar dalë-ngadalë kur kam qenë i ri është përmirësuar shumë dhe jemi lidhur me këto qytete, bile ka pasur edhe martesë. Edhe kur ka martesë, tash nuk martohen, të rinjtë martohen vetëm me njerëz të qytetit, qytezës ose fshatit të vet, vetëm me ata me të cilët janë në kontakt të afërt.

Nëna ime është nga Mitrovica, babai nga Vushtrria. Jo, babai im është nga Prishtina, mirëpo gjyshi im është nga Vushtrria. Kanë ardhur këtu nga Vushtrria. Kosova, kështu është Kosova, më vonë dalë-ngadalë është bashkuar. Jemi afruar me të gjitha qytetet dhe fshatrat brenda Kosovës. Vendbanimi më i vjetër i Kosovës është Vushtrria, Janjeva, ka qenë edhe një vend të cilin e quanin Novobërdë, një minierë, një kodër minierë, ajo është ngritur shumë moti. Vendbanimi i Prishtinës është ngritur pas ardhjes së osmanëve, menjëherë pas Betejës së Kosovës. Sulltan Pajaziti ka ardhur menjëherë, brenda tri ditësh ka ardhur në Kosovë, në fushëbetejën ku është varrosur babai i tij Sulltan Murati.

Ebru Süleyman: E keni fjalën për Gazimestanin?

Şükrü Zeynullah: Po, në Gazimestan. Babai i tij ishte varrosur dhe ai erdhi për të udhëhequr, për të udhëhequr gjithçka, Sulltan Pajaziti. Pastaj kanë marrë vendime të shpejta, çfarë do të ndodhë me martirët, si do të varrosen, disa prej tyre do të varroseshin në vendlindjen e tyre, e të tjerë. Dhe një prej vendimeve ishte të ngritet një vendbanim sa më afër Fushës së Kosovës që ishte e mundshme. Vushtrria ishte vendi më i afërt me Fushën e Kosovës. Sidoqoftë, në vijë ajrore Vushtrria është, le të themi 27-28 ose 25 kilometra larg. Kështu që, ata vendosën të mos e ndërtojnë vendbanimin atje sepse nuk ishte afër mjaftueshëm. Gazimestani, le të themi se distanca mes Gazimestanit dhe Prishtinës është katër-pesë, tre-katër kilometra. Prandaj, ata vendosën ta ndërtojnë vendbanimin këtu, në Prishtinë. Sepse kjo do t'u mundësonte të ishin afër martirëve në mënyrë që të mund t'i vizitojnë, t'u lexojnë *jasine*¹, të kujdesen për varrezat, të kujdesen për to, të mbjellin lule e gjëra të tjera. Kjo ishte arsyeja.... Kjo ishte...

Ebru Süleyman: Krijohet Prishtina...

Şükrü Zeynullah: Po, [Prishtina] krijohet menjëherë pas kësaj lufte. Terreni i Prishtinës është shumë i përshtatshëm. Perandoria Romake tentoi të krijonte një vendbanim por meqë mali ynë është shumë afër, kishte shumë rreziqe në kuptimin që armiqtë mund të vinin me shumë lehtësi dhe ta sulmonin vendbanimin nga mali. Për më tepër, mali ynë është mal me shumë, shumë shi. Tani shkurtimisht e quajmë Gërmia. Ka pasur shumë kafshë, për shembull arinj, mace të egra, ujç, gjarpërinj, e të tjerë. Vendbanimi nuk u krijua sepse ata ishin të frikësuar. Perandoria Romake nuk mundi të vendoste të krijonte një vendbanim këtu. Dhe disa gjëra të tjera... armiqtë mund të futen lehtë... edhe bizantinët tentuan, por nuk arritën ta bëjnë.

¹Jasini është surja e 36-të e Kur'anit.

Ekzistojnë disa fshatra nga kohërat e Bizantit. Në rrugën për Nish, kah Podujeva, diku aty. Është Bardhoshi, nuk e di, *Devet Jugović*, kanë ekzistuar disa fshatra serbe para osmanëve. Manastiri i Graçanicës u ndërtua poashtu diku në të njëjtën kohë. Manastirin e kishin ndërtuar para se të vijnë osmanët, 40 vite para luftës, Manastirin e famshëm të Graçanicës. Serbët kanë jetuar rreth asaj zone.

Siç thashë më parë, kjo ishte arsyeja më e madhe pse u krijua Prishtina këtu. Për një arsye, një qëllim. Do të thotë, gjithçka ka filluar me turqit [osmanët], me kohë, me punë, për një qëllim. Për një arsye, një qëllim të vetëm, i cili ishte për të qenë më afër martirëve. Të plagosurit kanë qëndruar, kanë ndërtuar shtëpitë e tyre, kanë bërë fëmijë dhe janë vendosur në qytezë. Kjo është arsyeja pse qyteti u emërua Prishtinë. Për një arsye, *pir* [numri një në turqisht] dhe *iş* [punë/detyrë në Turqisht], kështu formohet fjala *Priştine* dhe vazhdon të qëndrojë sot e kësaj dite.

Këtu, siç e dijmë, një vend zyrtar, një ndërtesë që është formuar nga osmanëve është *masjid*². *Masjidi* ekziston sot e kësaj dite. Sidoqoftë, quhet *Masjidi* i Paemërar, pa emër. Sepse themelimi i tij filloi në të njëjtën kohë me Xhaminë e Sulltan Muratit. Në të njëjtën kohë, sepse njerëzit kishin nevojë të luteshin diku deri të përfundohej xhamia.

Ebru Süleyman: Ku është ky *masjid*?

Şükrü Zeynullah: Ky *masjid* ekziston sot e kësaj dite në Prishtinë. Sidoqoftë, njerëzit nga Prishtina nuk ia dinjë emrin, nuk e dinjë që quhet *Masjidi* i Paemëruar. Iu kam treguar disave, gjithashtu kam shkruajtur në një libër për të. Po flasim për ndërtesën ku sot gjendet klubi i boksit. *Masjidi* i Paemëruar.

Ebru Süleyman: Pra, klubi i sotshëm i boksit ka qenë *masjid* më parë?

Şükrü Zeynullah: *Masjid*, po, ka qenë *masjid*. Shiko sa e fortë është ndërtesa, ende qëndron. Ka qenë edhe qendër e gjimnastikës dikur.

Ebru Süleyman: Axha Şükrü, unë kam dëgjuar se ajo ndërtesë më parë është shfrytëzuar nga komuniteti i hebrenjve.

Şükrü Zeynullah: Jo ajo, ndërtesat përreth saj, hebrenjtë kanë ndërtuar shtëpi përreth tij, përreth *masjedit*. Komuniteti i hebrenjëve ka qenë i vendosur aty, por edhe në pjesë të ndryshme të Prishtinës. Hebrenjtë kanë ardhur nga Evropa. Evropa i ka përzënë hebrenjtë dhe osmanët i kanë mirëpritur, kaq. Na kujtohen këto lloj gjërash nga fëmijëria, por atëherë nuk e kemi ditur prapavijën fare. Historia e Prishtinës është e pasur.

²*Masjid* në arabisht bukvalisht do të thotë xhami. Sidoqoftë, në shumë gjuhë jo-arabike, termi përdoret për t'iu referuar një vendi musliman për lutje i cili është më i vogël se xhamia.

Kur kanë ardhur osmanët dhe kanë kaluar përmes një vendi të quajtur Janjeva, kur e kanë kaluar Janjevën kanë parë një fushë të madhe përpara vetes. Kjo ishte Fusha e Kosovës. Vetëm ushtarët ishin në atë fushë. Në atë fushë kanë parë shumë zogjë, zogjë {shikon përreth i habitur}. Sot në Prishtinë nuk ka vetëm lloje të ndryshme, por edhe shumë specie në Prishtinë. Kështu, duke biseduar dhe duke vëzhguar rreth vetes, ushtarët kishin harruar se ishin në luftë. Lu kishin pëlqyer aq shumë zogjtë, sa që kishin vendosur ta emërojnë *Kuş Ovasi* [Fusha e Zogjve]. Atë vend, për shkak të kësaj, emri i saj sot është *Kuş Ovasi* ose *Kos ovasi*, Kosovë.

Ebru Süleyman: Axha Şuçri, a të kujtohet kur ke qenë fëmijë, çfarë ke bërë, ku ke jetuar, cilat lagje kanë ekzistuar, kush ka qenë përreth? Nëna, babai, gjyshja, gjyshi, a të kujtohen?

Şükrü Zeynullah: Natyrisht. Prishtina ka qenë shumë e gjerë atëherë. Ka pasur plot shtëpi të bukura, mahnitëse. Fasadat e tyre të jashtme ishin të gjitha të gdhendura me dru, gjithçka ishte punëdore, shumë bukur, më kujtohet shumë mirë. Disa prej tyre kanë qëndruar për kohë të gjatë. Ka pasur shumë lagje, nëse i numëroj lagjet, do të them se kanë qenë nëntëmbëdhjetë. Nëntëmbëdhjetë lagje të mëdha. Nga Tophanja në *Divan Yol*, apo duhet të them *Panayir Ovasi* [Fusha *Panayir*], plot lagje të ndryshme.

Ebru Süleyman: Ku, ku është kjo Fusha *Panayir*?

Şükrü Zeynullah: Fusha *Panayir*, e ke parasysh teatrin? Menjëherë prapa teatrit, rrugës përpjetë.

Ebru Süleyman: E keni fjalën për *Dört Lüle* [Katër Llullat] apo jo?

Şükrü Zeynullah: Më fal?

Ebru Süleyman: Në drejtim të *Dört Lüle*, apo jo?

Şükrü Zeynullah: Po, në atë rrugë. Ec pak më lart në drejtim të parkut të qytetit, ajo rrugë të çonte në park.

Ebru Süleyman: Pra, ju keni jetuar në këtë anë të qytetit. Në pjesën e vjetër që zgjerohet deri te parku dhe në anën tjetër deri te *Divan Yol*?

Şükrü Zeynullah: Deri tek parku i qytetit dhe *Divan Yol*, në drejtim të bahçeve. Pjesa ku është sot stadiumi ka qenë e gjitha me bahçe, bahçe me perime. Dy lumenjtë kanë rrjedhur anej. Dy lumenj të mëdhenj të cilët më vonë u bënë përronjë. Vellusha në lagjen *Posderka*, lagjja *Pos-dere*³ apo lagjja e përroit apo ndonjë emër tjetër, emrat e lagjeve kanë ndryshuar ndonjëherë. Emri i parë i asaj lagjeje ka

³ Turqisht: *dere*, bukvalisht do të thotë lumë. Në këtë rast, lagjja emërohet në bazë të lumit.

qenë *Oniçi Kavak Deresi* [Lumi me Dymbëdhjetë Plepa]. Sepse zgjatej nga plepat, kalonte nëpërmjet urës së *Divan Yolit* në drejtim të bahçeve ku bashkohej me lumin Vellusha. Rrotat punonin, rrotat e ujit për të ujitur bahçet. Bahçet zgjateshin përjetë deri tek fabrika e amortizatorëve, ndoshta ke dëgjuar për të ose për shkollën, ka qenë aty një shkollë e mesme. Bahçe me perime në të majtë dhe në të djathtë. Ne fëmijët e kemi ditur, kemi shkuar në shkollë në gjuhën serbe, në gjuhën serbe.

Ebru Süleyman: Në cilin vit, cilat vite?

Şükrü Zeynullah: ‘37, kam filluar në vitin 1937, ‘38, në vitin ‘37-‘38. Më kujtohet vdekja e Atatürkut të ndjerë. Lajmin për vdekjen e tij e patëm marrë nëpërmjet lajmrimit. Atëherë kam qenë djalë i ri, kam qenë bashkë me Tavukçiun kur kemi dëgjuar lajmin nga Rexha, nga radio. Ata njerëz, të moshuarit tanë dëgjonin radion e Ankarasë. Ekzistonin rreth 30 radio të markës Rayon, markë e vjetër. Kudo ku kishte radio të tilla, njerëzit mblidheshin dhe dëgjonin, nëse shqetësoheshin për shëndetin e Mustafa Kemalit. Nganjëherë gëzoheshim kur ai bënte më mirë, me kohën ai u sëmur më shumë dhe u bë më keq.

Kemi dëgjuar për vdekjen e tij po atë ditë kur pati vdekur. Një burrë i quajtur Ziyadin, Ziyadin kishte një biznes me pula dhe gjela, prandaj e kemi quajtur Tavukçi [Tregtar shpendësh], edhe të tjerët e kanë quajtur njësoj. Ai e pati lajmëruar xhaminë. Pati shkuar në kafaz, morri tri pula apo gjelë, i shiti në rrugën menjëherë pranë pazarit dhe me paratë e fituara, ai ia dha paratë hoxhës dhe bëri që tri xhami të lexojnë lajmin për vdekjen e Atatürkut.

Atëherë, njerëzit ishin ndryshe. Prishtina ndryshoi [papritmas], asnjë zhurmë, asgjë, turma çdokund, dyertë e dyqaneve hapen por askush nuk hyn as nuk del. Tregëtia ndaloi. Prindërit u mblodhën dhe morrën vendime për kur dhe ku të mblidhen për përkujtim. Mevlydi për funeral duhej përgatitur, e kështu me radhë. Tregëtia ndaloi në atë kohë. Gratë në shtëpi, nënat dhe motrat i vendosën flamujtë turk në gjysëm-shtizë. Më kujtohet që i patën veshur fëmijët e vegjël, vajzat e vogla më shumë me fustane të zeza dhe fustane të kuqe e të bardha në rrugë. Më kujtohet që të posalindurit i emëronin ose Kemal ose Mustafa. Shumë prindër i emëruan fëmijët e tyre kështu. Më vonë, disa fëmijë patën shtuar emrin e tij në emrat e tyre, kur ishin dy-tre vjeç, para se të shkonin në shkollë. Për shembull, nëse një fëmijë quhej Ahmet, bëhej Ahmet Musafa, nëse ishte Mehmet, bëhej Mehmet Mustafa. Kemal ishte si emër shtesë poashtu. Tani, bash ditëve të fundit ka vdekur artizani ynë i njohur që kishte emrin Kemal si shtesë, ai quhej Ali Kemal që prej fëmijërisë.

Shumë ndryshime kanë ndodhur. Ky djalë, ky djalë i ri i cili i ka lajmëruar njerëzit shkon në Shkup me tren, me ftesën zyrtare të konsullatës turke. Tre njerëz e kanë pritur në stacion të trenit atje. E kanë falenderuar për këtë gjest të bukur. Ai bëri që njerëzit të lexojnë njoftimin. Ai qëndroi atje për dy ditë dhe ata i ofruan të shkonte në Turqi të bashkohej me të tjerët. Gjithashtu, Turqia i dhuroi një fermë si dhuratë. Fëmija fillon të mendojë, ka nënë dhe baba, nuk mund të vendosë të shkojë dhe e refuzon ofertën. Ai jep një deklaratë, “Më falni, Kosova është vendi im, Turqia është mëmëdheu im. Nëse

shkojmë në Turqi, çfarë do të ndodh me historinë tonë këtu? Çfarë do të bëhet me këto artefakte, monumente, me arkitekturën?” Sepse këtu kanë qenë 17-18 xhami dhe nëntë *masjide* e të tjerë. Shumë shtëpiza të dervishëve. “Kujt do t’ia lëmë këtë trashëgimi osmane? Nëse unë filloj të iki edhe miqtë e mi do të duan të ikin”. Kështu, iu falenderua dhe u largua. E refuzoi ofertën.

Sidoqoftë, më kujtohet që edhe pse kemi shkuar në shkollë në gjuhën serbe, ka pasur shkolla të Kuranit me Haxhi Amhetin në lagjen *Dört Lüle* dhe në disa lagje të tjera. Kam shkuar në atë shkollë dhe kam bërë tri lexime prej fillimit deri në fund të Kuranit. Shumë fëmijë shkonin tek Haxhi Ahmeti. E kemi pëlqyer shumë, e kemi dashur shumë Prishtinën dhe e kemi quajtur qytezë, edhe pse dalë-ngadalë kjo u bë qytet. Por ende, sot e kësaj dite njerëzit i thonë qytezë, qyteza e Prishtinës e të tjerë.

Ebru Süleyman: A ju kujtohet çfarë punonte babai, na treguat që ka shkuar në Shkup?

Şükrü Zeynullah: Babai im ka trashëguar zanatin e gjyshërve të mi. Furrëtar, furrëtar. Ragip Aga furrëtari. Shtëpia jonë ka qenë në lagjen *Çeklik*. Ai ka ndihmuar në ndërtimin e një fontane aty, fontana e *Çeklikut*, që do të thotë thëllënzë. Ka pasur shumë thëllënza aty, prandaj lagja është quajtur *Çeklik*.

Ebru Süleyman: Ku gjendet kjo lagje?

Şükrü Zeynullah: Kjo lagje gjendet menjëherë pas xhamisë Aladin. Në fakt, xhamia Aladin është në atë lagje, në *Çeklik*. Shumë gjëra kanë ndodhur atëherë. Kemi pasur njerëz të njohur, ka qenë mjeku Tefik Raşit, ai ka qenë doktor. Më parë ishte njëfarë Cabiri, Cabir hajduti, e quanim vjedhës. Sidoqoftë, ai ishte njeri i sinqertë dhe keqkuptohej. Ai me mjeshtëri vidhte nga të pasurit, ka pasur një karrocë të vjetër me dy rrota, vidhte dhe iu dhuronte të varfërve. I merrte gjërat në shtëpi dhe pastaj i dhuronte. Ishte hajdut, vjedhës mirëpo njeri i mirë. Kur futej në një dyqan apo kafiteri, të gjithë ngriteshin në këmbë. Ishte shumë i sinqertë. Gjithashtu...

Ebru Süleyman: Kur ishte kjo? Në kohën e Mbretërisë së Jugosllavisë?

Şükrü Zeynullah: Kjo ishte para se të vdiste Ataturku. Nga hera e parë e Ataturkut [kur ai erdhi në pushtet]. Kjo ishte në atë kohë. Gjithashtu, ky tregim dalë-ngadalë bëhet i njohur në të gjithë botën.

Ebru Süleyman: Domethënë dikur në kohën e Luftës së Parë Botërore?

Şükrü Zeynullah: Në Luftën e Parë Botërore, në atë periudhë, atëherë. Gjithashtu, ende sot e kësaj dite flitet për të si hajduti i sinqertë nga Prishtina. I sinqertë, pa gënjeshtër, ishte shumë nejrëzor, i ndihmonte njerëzit. Vdiste urie për vete në mënyrë që të mund t’iu dhuronte ushqim të varfërve.

Historia e Prishtinës është e pasur dhe e gjerë. Ka pasur shumë njerëz. Ka qenë një zanatli, Salih, Salçe. Ai ka jetuar më shumë se nëntëdhjetë vjet. Ka vdekur para 55 vjetësh. Ka qenë zanatli i hatashëm,

artist i mrekullueshëm. Të gjithë lordët, gjeneralët nga Anglia dhe Franca kanë ardhur dhe kanë porositur pajtonë nga ai. Ata kanë punuar pajtonët më luksoz dhe më të bukur për njerëzit e pasur të Evropës.

Mandej ishte Bayram Kovaçi dhe familja e tij. Ata bënë shpata për admiralë dhe ushtarë. Shpata, thika dhe gjëra të tjera. Do të thotë, edhe ai ishte i njohur dhe kishte edhe shumë të tjerë të njohur. Nuk më kujtohen tani, po emocionohem, po emocionohem. Nuk di nga t'ia filloj, cilin shembull të të jap më parë. Kemi pasur shumë njerëz të njohur, shumë. Më vonë...

Pjesa e Dytë

Şükrü Zeynullah: Shiko, atëherë e kemi folur turqishten e vjetër. Kemi thënë 'c' në vend të shkronjës 'g', 'ç' në vend të shkronjës 'k' e të tjerë.

Ebru Süleyman: A është e njëjtë me këtë që po flasim tani, a keni folur kështu më parë?

Şükrü Zeynullah: Jo, tani flasim gjuhën zyrtare turke [të standardizuar]. Atëherë nuk kemi ditur asgjë. Nëse do të thoshe *geldim* [erdha], *gittim* [shkova], askush nuk do të të kuptonte. *Coldum*, *cittim* [erdha, shkova]...

Ebru Süleyman: Jo, po them kështu siç jemi duke folur tani.

Şükrü Zeynullah: Më fal?

Ebru Süleyman: Siç jemi duke folur tani.

Şükrü Zeynullah: Jo, nuk ishte kështu.

Ebru Süleyman: Kështu siç po flasim unë dhe ju tani?

Şükrü Zeynullah: Jo, nuk ishte kështu. Nuk ishte kështu, nuk ishte. Nuk ka pasur shkolla atëherë.

Ebru Süleyman: Cili ishte dallimi?

Şükrü Zeynullah: *Cittim*, *coldum* [erdha, shkova]. Qytetarët e Vushtrrisë flasin një turqishte tjetër, të Mitrovicës një tjetër dhe ato kanë vetëm gjashtë kilometra ndërmjet në vijë ajrore. Më parë shkohej nga Vushtrria në Mitrovicë në këmbë. Vushtrri-Mitrovicë, apo jo? Turqit e Mitrovicës flisnin tjetër turqishte, ata të Vushtrrisë tjetër. Për shembull, ata të Vushtrrisë thoshin *isteymisi* [A dëshiron?], *cidymisi* [A do të shkosh?], *oynaymisi* [A do të luash?], e keni parasysh? Ata të Mitrovicës nuk i

kuptonin. Turqit e Mitrovicës thoshin *dermuga* [Të tregosh], *almuga* [Të marrësh], *citmuga* [Të shkosh]. A po kupton? Ata nga Prishtina *coldum*, *cittim* e kështu me rradhë.

Ebru Süleyman: Ne ende themi *coldum*, *cittim*.

Şükrü Zeynullah: Po, por le të themi, Peja është ndryshe, Prizreni ndryshe, Gjlani ndryshe. Sidoqoftë, në përgjithësi, në Gjilan është folur turqishtja më e saktë. Shiko, kjo është çështje e rëndësishme. Nëse më pyet pse? Sipas meje, sa më afër që je...

Ebru Süleyman: Turqishten e Stanbollit.

Şükrü Zeynullah: Sa më afër Anadollit të jesh, pra më afër Stanbollit, pra Turqisë aq më e mirë është turqishtja. Për shembull, Kaçanik, Kaçanik. Kushdo që ka bërë ndonjë akt ilegal fshihej atje [në Kaçanik]. Dikur i quanin ato kodra *Kaçanlık* [Tur: vend për t'u fshehur]. Sot e quajnë Kaçanik, dikur ishte *Kaçanlık*. Pas atyre kodrave njerëzit e flisnin më mirë turqishten. Njerëzit thonin *geldim* [erdha], *gittim* [shkova], *iki tane* [dy pjesë] në vend të *içi tane* [dy pjesë]. Gjilani ishte më afër Maqedonisë, andaj edhe e flisnin...

Ebru Süleyman: Tingllon më shumë sikur turqishtja e Stanbollit.

Şükrü Zeynullah: Tingllon më shumë sikur turqishtja e Turqisë. Turqishtja e Turqisë. Pak më ndryshe.

Ebru Süleyman: A do të thotë kjo që turqishtja e vjetër është folur nga secili, ashtu flisnin njerëzit në qytet?

Şükrü Zeynullah: Secili, secili e ka folur. Atëherë kur vendbanimet po krijoheshin ngadalë në Prishtinë, serbët erdhën, boshnjakët poashtu. Hebrenjtë nga Evropa, jo shumë por (e pakupt.) Shqiptarët nga jugu, shqiptarët vendoseshin në periferi të qytetit, pasi që ata ishin bujq. Sidoqoftë, qytetarët punonin më shumë zanate, ishin zanatli.

Ebru Süleyman: Cilat zanate ishin?

Şükrü Zeynullah: Më fal, si?

Ebru Süleyman: Cilat zanate ishin atëherë?

Şükrü Zeynullah: Ishin këto zanatet, filluar nga argjendar, këpucëtar deri te rrobaqepësi. Kemi pasur rrobaqepës shumë të njohur, berber shumë të njohur. Berberët ishin si mjekët. Për shembull, Ahmet Kırna, ai i bënte disa ilaqe për njerëzit, për reumatizëm, për çka tjetër, për asma apo... kam shumë gjëra në mendje, por më janë ngatërruar, nuk e di se çfarë të them.

Ebru Süleyman: Kemi mjaft kohë.

Şükrü Zeynullah: Kishte edhe mjekë poashtu. Por ishte edhe një mjek, Doktor Tefiku. Doktor Tefiku, ai ishte shumë i njohur në Evropë. Kur ai shkoi në Evropë... këtu ai do kujdesej për njerëz...

Ebru Süleyman: A ka studiuar ai në Evropë?

Şükrü Zeynullah: Jo. Po, në Evropë, natyrisht që në Evropë.

Ebru Süleyman: Tani erdhi këtu.

Şükrü Zeynullah: Po, këtu. Tefik, mbiemrin e kishte Raşit. Ka jetuar afër Kacallarëve, drejt qytetit në mahallën *Çeklik*. Shtëpia e tij ishte aty, është ende aty, një shtëpi e vjetër. Ai shkoi në Evropë, ata e kërkuan atë, ata kishin dëgjuar për të dhe e kishin ftuar në Evropë. Ai vinte e shkonte, por jo më dhe aq.

Mjekët evropian kërkonin këshilla nga Tefiku për shumë gjëra. Mjeku Tefik kujdesej për pacientët e tij në disa familje, familje të pasura dhe u tregonte si të vepronin në lidhje me sëmundjen dhe cilin ilaç ta përdornin. Sidoqoftë, pasi që ato familje ishin të pasura, ata i dërgonin të sëmurët e tyre në Evropë për kontrolla mjekësore që edhe mjekët evropian t'i diagnostifikonin, në Francë, në Austri. Kur ata doktorët e pyetën, "Prej nga jeni?" Prej nga keni ardhur?" "Nga Prishtina". "A e njihni mjekun Tefik?" "Po". "A ju ka kontrolluar ai?" "Po". "Çfarë u ka thënë ai, ashtu është. Ne nuk mund të dijmë më mirë se ai". Mjekët ashtu thonin atëherë.

Kishte shumë ngjarje në Prishtinë, ngjarje të mëdha, por asnjëra nga ato nuk është shkruar. Të paregjistruara. Ne kishim zanatli të mirë, berberët tonë ishin mjekët tanë. Rrobaqepësit ishin ata që e krijonin modën, poashtu edhe këpucëtarët. Kishim pazarin e mbuluar, aty... e shkatërruan atë pazar, shumica u shkatërruan, shumëçka që ishte e jona.

Ebru Süleyman: Axha Şuçri, a ju kujtohet, ndoshta pas Luftës së Parë Botërore jeta ka qenë e vështirë këtu? Kur ishin fëmijë, kur shkoje në shkollë, atëherë filloi, pasi që vdiq Ataturku, Lufta e Dytë Botërore filloi menjëherë. A ju kujtohen këto ngjarje, si ishin gjërat?

Şükrü Zeynullah: Unë e kujtoj Luftën e Dytë Botërore, por jo Luftën e Parë Botërore.

Ebru Süleyman: A ke dëgjuar ndonjë gjë nga gjyshja apo gjyshi?

Şükrü Zeynullah: Po, Lufta e Parë Botërore e kishte lënë Prishtinën në gërmadha. E la atë shumë mbropa. Prishtina nuk mund të zhvillohej në atë kohë. Para Luftës së Dytë Botërore disa ndryshime të

mëdha ndodhën, qyteti u bë shumë modern, me më shumë ndërtesa moderne. Ngadalë e bëri tranzicionin nga *a la Turca* në *a la Franga*. Ndërtesat filluan të duken edhe më të bukura, në stil evropian e të tjera. Sidoqoftë, ato ndërtesa poashtu u shkatërruan pas Luftës së Dytë Botërore. Kur lufta Nacional Çlirimtare ndodhi, ato ndërtesa u shkatërruan, gjithçka u shkatërrua gjatë komunizmit. Komunizmi bëri shumë gabime. Kombet e shpërndanë, qytetarët e Prishtinës nuk mundën të përballojnë, duruan për pak kohë por nuk mundën më shumë dhe migruan në mëmëdheun e tyre Turqinë.

Ebru Süleyman: A mundeni... a ju kujtohet kur ushtarët bullgar dhe italian erdhën këtu?

Şükrü Zeynullah: Po, natyrisht.

Ebru Süleyman: A mund të na tregoni pak për ato ditë?

Şükrü Zeynullah: Gjermanët erdhën. Italianët ishin aleatë të gjermanëve. Sidoqoftë, gjermanët nuk ishin me vend-ndodhje në Prishtinë, më shumë italianët. Në mes të vitit '41 deri '44, kishte shumë konflikte, mosmarrëveshje, krisma të vogla. Edhe pse u formua organizata e të rinjve këtu, ata ishin partizanët e rinjë. Ata punonin në programe nën urdhërin e Titos. Do të thotë, diçka si socialistë, si komunistë. Pra të rinjtë tanë iu bashkonin asaj. Njerëzit si Meto Bajraktari, Selimler, Kocadiş, Raşit dhe shumë të rinjë të tjerë. Më vonë, edhe fëmijë e vegjël iu bashkonin, Süleymani jonë, mbiemrin Süleyman...

Ebru Süleyman: Şerafedin.

Şükrü Zeynullah: Şerafedin Süleyman. Edhe ai ishte misionar partizan. Vëllau më i madh, më i vjetri ai...

Ebru Süleyman: Remzi, Remzi.

Şükrü Zeynullah: Po, ata luftonin kundër armiqëve lokal dhe si ta them, kundër gjermanëve. Konfliktet ndodhnin në Keçekollë, aty konfrontoheshin. Meto Bajraktari vdiq, edhe disa të tjerë vdiqën dhe shumë të tjerë vdiqën. Por pas Luftës Nacional Çlirimtare, këtu secili komb i fitoi të drejtat e veta: serbët, shqiptarët, të tjerët, vetëm turqit, turqit nuk i fituan të drejtat e tyre. Andaj qyteti filloi të shembej, njerëzit filluan të migrojnë për në mëmëdhe.

Ebru Süleyman: Qytetarët?

Şükrü Zeynullah: Qytetarët, të qytetit. Qytetarët.

Ebru Süleyman: A ju kujtohet kur ata po migronin me tren?

Şükrü Zeynullah: Çka ishte?

Ebru Süleyman: Kur ata migronin për Turqi.

Şükrü Zeynullah: Natyrisht, kemi edhe fotografi. Ata lotë, ato ndarje. Çdo ditë kishim përshendetje lamtumirëse, dërgonim njerëz nëpër trena. Braktisnin shtëpitë e tyre, gjësendet.

Ebru Süleyman: Pse u larguan pasi që lufta mbaroi?

Şükrü Zeynullah: Komunizmi, koha e komunizmit. Ashtu ishte.

Ebru Süleyman: Pse kishte vendosur familja juaj të qëndrojnë?

Şükrü Zeynullah: Pse qëndrojnë sot?

Ebru Süleyman: Jo, atëherë. Më përpara.

Şükrü Zeynullah: Oh, pse kanë vendosur?! Djemtë e tyre kishin derdhur gjak në Gazimestan, në betejë. Ata... ata... nga trashigimtarët e tyre familje të tëra ishin krijuar këtu, nga fëmijët e tyre. [Për shembull] Babai i tij vdiq, por fëmiu mbeti gjallë dhe jetoi në Prishtinë. Ata janë ende këtu në këto lagje deri në ditët e sotme, trashëgimtarët e martirëve. Ende.

Ebru Süleyman: Ju nuk keni dashur të largoheni?

Şükrü Zeynullah: Nuk kishim zemër të largoheshim. Nëna ime u largua 1938-37, në '37-tën. Unë isha tre vjeçar atëherë, gjatë synetisë sime, ajo kishte një familje të madhe në Mitrovicë. Një kallaballëk familje, të gjithë vendosën të largohej. Ata mendonin që edhe nëna ime do të dëshironte të shkojë, por babai im nuk mund ta bënte, ai nuk mund të largohej. Babai im nuk donte. Ata u munduan ta bindnin bashkë me tezet e mia, tezet më të vjetra, dy më të vjetra. Ato e lutën dhe nëna ime dëshironte të largohej, por si mund t'i braktisësh njerëzit e tu ashtu? Por, ata u larguan.

Ne dikur jetonim në Shkup, ata erdhën dhe e morën atë me pajton nga Mitrovica. E kuptova që diçka po ndodh, edhe pse isha vetëm tre vjeç në moshë dhe ishte dita e synetisë sime. Vrapova shkallëve poshtë. Shtëpia jonë ishte afër lumit dhe aty kishte një urë në një distancë prej pesë-gjashtë metrave, sapo hapa derën, rashë në lum, dhe ata më tërhoqën nga lumi.

Ebru Süleyman: A ishte kjo në Shkup? Në Shkup?

Şükrü Zeynullah: Në Shkup, dikur shkonim aty. E takova nënën time pas vitit '51. Mendoj që në '51-tën, kur isha njëzet. Shkova takova nënën time kur isha njëzet e një vjec në moshë.

Ebru Süleyman: Pra nëna juaj shkoi në Turqi, apo?

Şükrü Zeynullah: Shkoi, shkoi. Babai im mbeti këtu.

Ebru Süleyman: Ju qëndruat me babain tuaj?

Şükrü Zeynullah: Babai im qëndroi, po. Babai im u martua me një artiste nga Budapesti i Hungarisë. Ata erdhën në Shkup me një trupë teatrale, ajo ishte aktore. Ata pëlqyen njëri tjetrin aty, më pas ajo qëndroi këtu dhe u martuan. Kur erdhëm në Prishtinë, unë atëherë shkoja në shkollë, në shkollën e Kuranit. Ajo kujdesej për mua, kujdesej shumë për mua. Ata dikur kalonin shumë mirë. Sidoqoftë, unë u ktheva nga shkolla një ditë, nga hoxha; ajo mori çantën time, nxorri Kuranin nga çanta dhe e gjuajti atë. Kishte tollovi para derës, ne atëherë jetonim në *Çeklik*, jo në *Dört Lüle*. Kur babai im erdhi në shtëpi dhe dëgjoi për këtë, nuk mund të pajtoheshin më dhe u ndanë. Pastaj u martua me gjyshën e saj {bën me dorë në drejtim të vajzës së tij që ndodhet në dhomë}... Fahriye ishte emri i saj. Për një kohë...

Ebru Süleyman: Çfarë gjuhe flisnit ndërmjet veti?

Şükrü Zeynullah: Kush?

Ebru Süleyman: Babai yt dhe gruaja e tij nga Hungaria?

Şükrü Zeynullah: Flisnin ngadalë serbisht, gjuhën serbe, më pas filluan të mësojnë turqisht sepse në atë kohë shumica mësonin turqisht. Madje edhe serbët flisnin dikur turqisht. Për shembull, një serb dikur fliste turqisht me mikun e tij, me mikun e tij turk dhe turku ia kthente në serbisht. A e kupton? Nga mirësjellja, kishte mirëkuptim.

Ebru Süleyman: Ndërmjet kombësive tjera poashtu?

Şükrü Zeynullah: Ne kishin miq serb, nuk ishin ata më ndryshe aspak. Ishte shumë interesant, nuk mund të flasësh më për këto gjëra me lehtësi. Ne mallëngjehemi për ato ditë, aq shumë saqë kisha preferuar të jetojë tre javë në atë kohë sesa tre vjet në ditët e sotme. Sidoqoftë, kur i sheh fëmijët e tu, nipat dhe mbesat, fëmijët e tyre fillon të mendosh ndryshe. Çfarë të bësh, jeta është kështu.

Ebru Süleyman: Më pas keshkuar në shkollë. Çlirimi pas Luftës së Dytë Botërore më pas koha e Jugosllavisë filloi. Jugosllavia e Re.

Şükrü Zeynullah: Filloi Jugosllavia. Jugosllavia e Re, çdo gjë ndryshoi atëherë.

Ebru Süleyman: Si ka ndryshuar jeta juaj, çka ka ndryshuar në jetën tuaj të përditshme?

Şükrü Zeynullah: Ata u dhanë të drejta të gjithë popujve, të gjitha minoriteteve, por për turq, nuk ka turq këtu, nuk ka turq këtu... asnjë. Nuk mund të mbashë *fez*⁴, nuk mund të flasësh turqisht në rrugë. Dikur shkonim në shkolla shqiptare, ne nuk dinim shqip. Disa shkuan në shkolla në gjuhën serbe, çfarë të bëjnë, tash nuk ka më.

Ebru Süleyman: Pra, kur ka filluar arsimimi në turqisht, pas '55-'57-tës, apo?

Şükrü Zeynullah: Në '57, në '57-'58-tën. Sidoqoftë, shkollat turke filluan vetëm pas '51-tës.

Ebru Süleyman: Në '51-tën.

Şükrü Zeynullah: Deri në të '51-tën, do të thotë nga '41 deri '51 për dhjetë vjet nuk ka pasur turq këtu. Një turk nuk mund të deklaronte që ishte turk. Nuk mund të flisnim gjuhën tonë në rrugë. Për dhjetë vjet nuk kemi qenë të pranishëm. Pas kësaj, kur e bënë censusin, turqit ishin më shumë në numër sesa serbët, më shumë se shqiptarët, më shumë se ata.

Shiko çfarë është nacionalizmi. Në përgjithësi, nuk kanë faj shqiptarët, por në mesin e shqiptarëve ka të këqinjë, ka disa nationalist dashakeq në mesin e tyre. Për shembull, kur kam shkuar në Shqipëri, kam shkuar atje disa herë, ata gëzoheshin. Disa shqipëtarë dinin të flisnin turqisht. Isha atje para 15-20 vjetve, para 25 vjetve. Në kohën e Enver Hoxhës, isha me Enver Hoxhën dhe ai foli turqisht me mua. Kur më panë ata thanë, "*Erdh qeky prej Prishtine, ky turku*" [Shqip flet] Të gjithë u ngritën, kur thua turk në Shqipëri të gjithë shqiptarët ngritën.

Sidoqoftë, nëse thua se je turk i Kosovës, atëherë nuk ka shumë rëndësi. Shiko, shqiptarët në Kosovë poashtu kanë përparuar, kështu që bëjnë këso gjërash? Por çfarë t'i bëjsh, kështu kishte qenë e shkruar. Tash dalë-ngadalë po bëhet më mirë. Disa gjëra ndodhnin këtu e aty, por janë të shpejt t'ua mbyllin gojën nationalistëve, sepse shqiptarët kanë filluar të mendojnë. Nëse ata turqi të këqinj nuk do të kishin ekzistuar, emri i shqiptarëve nuk do të kishte ekzistuar në botë sot.

Me vite ata [osmanlinjtë] nuk janë tërhequr nga Ballkani. Mbështetur në një marrëveshje, ata kishin qenë të detyruar të shkojnë por [ata mbetën] derisa ata e krijuan shtetin për shqiptarët. Ata thanë, "Këtu e keni Shqipërinë shtetin tuaj dhe Zoti ju ndihmoftë për të mbarë!" Do të thotë, ata e krijuan Shqipërinë, nënshkruan në Kongresin e Berlinit dhe më pas filluan të tërhiqeshin. Përderisa largoheshin nga këto treva, kur u larguan nga Prishtina, e thirrën Hasan Prishtinën dhe disa shqiptarë

⁴ *Fez* është një kapelë e kuqe me një dekor të zi, e marrur nga Tunisi në kohën e Perandorisë Osmane, specifikisht në kohën e Sulltan Mahmudit të Dytë, i cili gjatë udhëheqjes së tij ishte munduar ta unisojë veshjen e vasalëve nga etnitë e ndryshme.

tjerë dhe u thanë, “Shiko, ne po largohemi, ngulni flamurët tuaj këtu. Do t’i keni tokat edhe në Kosovë”. Ata thanë, “Jo, ne do të bëjmë lehtësisht një marrëveshje me Mbretin e Serbisë”. Por, shih se çfarë ndodhi, pas gjithë atyre viteve ata disi ia arritën të bëjnë shtetin dhe ende nuk është funksional siç duhet. U futëm pak në politikë, nuk është mirë.

Ebru Süleyman: Më lejo të të pyes edhe diçka. A të kujtohet populli hebrej në qytet para Luftës së Dytë Botërore? Na tregove pak, the që kishte turqi, serbë, shqiptarë, hebrej, rom. Ku ishin në qytet, çfarë bënin këta popuj të përzier? Si kanë punuar, si kanë jetuar para Luftës së Dytë Botërore kur ti ishe fëmijë?

Şükrü Zeynullah: Romët për shembull kanë jetuar në dy mahalla: *Aşarçi Mahalle* [Mahalla e Poshtme] dhe *Yokarçi Mahalle* [Mahalla e Epërme]. Mahalla e Poshtme ishte një qendër e gjërë në *Divan Yol*. Lumi kalonte andej pari. Aty ishin ata, ata nuk ishin lëkurë mbyllët, ata ishin të bardhë, ata ishin ndryshe. Shumica prej tyre fliste turqisht dhe ata ishin të bardhë. Kur shkollat u hapën ata shkuan në shkollë turqisht.

Sidoqoftë, pjesa më e madhe e ciganëve, romëve jetonin në *Mor Ova* [Lugina e Vjollce]. *Mor Ova* që ka kuptimin e Morava. Moravska, është aty lartë. E din parkun, mbi park. Ajo ishte zona e tyre, ata ishin të grumbulluar aty. Ata ishin ngjyrë mbyllur, ata flisnin romani, por natyrisht edhe turqisht. Ata punonin si roje, punë të rënda. Ata kishin edhe intelektualë poashtu, ata punonin si kamarier nëpër restorante. Kishte edhe të tillë.

Në *Aşarçi Mahalle* [Mahalla e Poshtme] kishte artistë, muzicentë të njohur. Klarinetisti Şükrü Tonar e qanim, Abdullah, İbrahim Peçevi violinisti. Hüriye Telleyici, ajo ishte këngëtare, ajo kishte edhe bendin. Jo, jo Hüriye Telleyici, Hüriye Telleyici është një person tjetër Hüriye violinistja, ajo luante violinën dhe kishte një orkestër me gra. Poashtu, ishte edhe, ju tregova për Savçen, i cili punonte pajtonat. Bayram Kovaç, me familjen e tij, ata punonin shpata dhe thika shumë të mira.

Ebru Süleyman: Ku jetonin serbët?

Şükrü Zeynullah: Serbët. Në një rrugë kanë qenë dy-tre shtëpi, e katërta ka qenë serbe. Tani prapë edhe disa shtëpi, tani prapë një e serbëve në një lagje tjetër. Ishin dhjetë serbë në një lagje.

Ebru Süleyman: Së bashku me kend, turqi, shqipëtarë?

Şükrü Zeynullah: Dhe serbët, jo tjerë. Hebrenjtë, gjermanët i mblodhën hebrenjtë dhe i morrën prej këtu shumë prej tyre. Nuk kishin mbetur më hebrej. Ne i shpëtuam vetëm fëmijët, i vendosëm në djepat tonë sikur të ishin fëmijët tanë. Të rriturit u morën nga gjermanët.

Ebru Süleyman: A të kujtohet kur ka ndodhur?

Şükrü Zeynullah: Natyrisht. Sa njeriun e kemi shpëtuar, disa të rritur poashtu, “Jo, ky është vëllau im, jo ky është i afërm i imi, ky i afërm...” Ne shpëtuam aq sa mundëm. Kishte një mirëkuptim mes nesh, nuk kishte armiqësi. Shqiptarët dhe ne kemi të njëjtën fe, shqiptar-turk njëjtë. Ne e kemi dashur njëri tjetrin, nuk kemi ku të shkojmë. Ne ua dhamë vajzat tona shqiptarëve, ne morëm nuse nga ta, e të tjera. Por, nuk kemi dashur të kemi asgjë me ata shqiptarët, me ata nacionalistët. Ata e kanë gabim.

Pjesa e Tretë

Ebru Süleyman: Zanatli, kishte zanatli?

Şükrü Zeynullah: Nuk ka më zanatli. Shqiptarët vinin nga Shqipëria sepse ne nuk kishim mësues pas luftës. Disa shqipëtarë kryen shkollën fillore në gjuhën serbe, por shumë rrallë. Sidoqoftë, mësuesit dhe profesorët erdhën nga Shqipëria dhe shkollat u hapën, jepnin mësim në Shkollat Pedagogjike.

Ebru Süleyman: Pra, ju shkuar në gjuhën serbe në shkollën fillore, apo?

Şükrü Zeynullah: Klasën e parë të shkollës fillore në serbisht. Kur erdha, kur ne erdhëm në Prishtinë në ‘41-‘42-tën, në të ‘41-tën unë shkova në klasën e dytë në shqip.

Ebru Süleyman: Do të thotë kishte shkolla në shqip në atë kohë.

Şükrü Zeynullah: Atëherë shqipëtarët erdhën këtu. Ky regjion u bë Shqipëria e Madhe, *Shqipnija e Madhe* [Në shqip], a kupton? Shqiptarët ishin aleatë të italianëve, Italia dhe Shqipëria. Poashtu, si e kishte emrin, Ahmet Zogu... çfarë isha duke thënë?

Ebru Süleyman: Vazhdo të lutem.

Şükrü Zeynullah: Nga ‘41 deri në fund të ‘44-tës, deri ‘45-tën, kjo është përafërsisht pesë vjet. Për pesë vjet, gati se çdo fëmijë ka shkuar në shkollë në gjuhën shqipe. Serbë, turq, secili, shqipëtarët, të gjithë shkuan në shkollë në gjuhën shqipe. Nuk kishte në tjetër gjuhë. Ne nuk mund të flisnim me zë në rrugë turqisht, vetëm në shtëpi brenda. Kështu ishte. Sidoqoftë, kjo popullsia shqipëtare nuk ka faj, vetëm disa dashakeqës në mesin e tyre.

Ebru Süleyman: Tani, lufta për pavarësi ndodhi, italianët u larguan, partizanët erdhën dhe çdo gjë ndryshoi. Na tregove diçka për atë kohë. Tani në vitin ‘51, turqit nuk u njohën [si etni në vete]...

Şükrü Zeynullah: Jo, jo.

Ebru Süleyman: Pas '51-tës, shkollat filluan të hapeshin.

Şükrü Zeynullah: Shkollat u hapën.

Ebru Süleyman: Çfarë bëje në atë kohë, sa vjeç ishe, a kishe kryer shkollën tashmë?

Şükrü Zeynullah: Atëherë, punoja në Ansamblin e Këngës dhe Vallës Popullore, ansambël i shtetit.

Ebru Süleyman: Çfarë punoje aty?

Şükrü Zeynullah: Performoja aty. Unë performoja aty. E kishin edhe në Prishtinë. Kishte qytetarë nga Prishtina aty, kishte shqipëtarë, serbë, turqi. Unë isha aty për një vit dhe pas një viti u bëra asistent i menaxherit.

Ebru Süleyman: Në cilat vite?

Şükrü Zeynullah: Këto janë të '50-tat, në të '50-tat. Në '49-'50. Në '49-'50. Unë isha shumë i ri atëherë kur u bëra asistent i menaxherit. Menaxheri ishte një rus, por atëherë ngjyrat e tij të vërteta dolën në pah, ai ishte Bolshevik. Atëherë, babai i tij ishte armik i komunistëve dhe çka jo tjetër. Ai u largua më pas dhe unë u bëra menaxheri për një vit. Unë isha shumë i ri. Sidoqoftë, në '51-tën shkollat u hapën, dëgjuam që do të hapeshin. Tani unë braktisa gjithçka dhe shkova në turqisht në '51-tën, në shkollën turke. Atëherë shkonim në Shkup për katër muaj gjatë verës, e përfundonim një vit shkollor dhe ktheheshim.

Ebru Süleyman: Kush ishin mësuesit tuaj?

Şükrü Zeynullah: Mësuesit tanë.

Ebru Süleyman: Kur u hap në fillim. Të parët?

Şükrü Zeynullah: Do të thuash shkolla turke?

Ebru Süleyman: Po.

Şükrü Zeynullah: Süreyya, Süreyya Yusuf në krye, ke dëgjuar për të.

Ebru Süleyman: Po, kam dëgjuar për të, patjetër.

Şükrü Zeynullah: Süreyya dhe dy njerëz të tjerë erdhën nga Shkupi.

Ebru Süleyman: Pra ju ishit duke studiuar në Shkup dhe pastaj jeni kthyer këtu?

Şükrü Zeynullah: Shiko, ka turq në Maqedoni, do të thotë Jugosllavi të gjithë ne. Ka turq në Maqedoni, turq në Serbi, turq nuk e di se ku, gjithkund në Mal të Zi, ka ende disa në Tivar, por jo në Kosovë. Kishte [turq] në Serbi deri vonë. *Viran Yer*, Vranjë i thonë. Ose *Bilaç*, *Biljača* një vend i vjetër turk. Kishte turq në Serbi deri vonë. Megjithatë, nuk kishte [shkolla] turke këtu deri në vitin '51? {tregon me gjeste që është në mëdyshje}. Por ky vend i përkiste Serbisë në kohën e Judosllavisë. E shihni sa keq ishte për ne. Pastaj filluan migrimet, njerëzit filluan të largohen. Përndryshe, ata do të ishin këtu, të gjithë do të ishim këtu.

Disa profesorë erdhën nga Shkupi, ose nga Shkupi ose Gositavari deri sa u rritëm. Studionim dhe ktheheshim këtu. Nuk kishte vende për të lënë fëmijët. Ata na dhanë një ndërtesë të vjetër që bënin çilima në të. Para "Elena Gjikës" ishte një shkollë e vogël, na e dhanë. Ishin pesë-gjashtë dhoma, kemi mbajtur mësim aty, në shtëpinë e Globoderit, në rrobaqepësi të Ahmetit, në shtëpinë e rrobaqepësit Abdullah. Ishte Xhamia e Aladinit, kishte klasa të zbrazura aty, jo klasa por dhoma. Ne i shëndrruam në klasa. Me mijëra fëmijë, gjashtë klasa, vetëm gjashtë klasa. Gjashtë klasa, do të thotë gjashtë dhoma. Por qindra fëmijë.

Në anën tjetër, klasat e shqiptarëve po zvogëloheshin. Shqiptarët nuk rrinin në mësim. Për shembull, nga tridhjetë fëmijë... mësuesit ose drejtori vinin dhe e njoftonin klasën në shqip që shkollat turke po hapeshin dhe nëse prindërit e trye vendosin që ata të shkojnë atje ata duhet të i njoftojnë. Të i njoftojnë deri të hënën. Ne erdhëm të hënën dhe ju thamë, "Babai ynë dëshiron që ne të shkojmë në shkollë turke", për shembull. Pastaj mësuesi që fliste shqip tha, "Kushdo që dëshiron të shkojë duhet të dal nga klasa". Për shembull, nga tridhjetë-tridhjetë e pesë njerëz vetëm shtatë qënduran në shkollën shqipe. Ashtu. Klasat më së shumti të mbushura me nxënës ishin klasat turke nga viti '51 deri '62-'63. Pastaj u rritën edhe më shumë...

Ebru Süleyman: Ti ishte mësues gjatë atyre viteve?

Şükrü Zeynullah: Kam qenë mësues gjatë atyre viteve. Mësues, drejtor. I kam menaxhuar shkollat turke, kulturën, Shoqatën e Arteve Pamore, korin turk, teatrin turk. Kam qenë themelues i teatrit, si ju kanë thënë *Hacivat* edhe tjetra...

Ebru Süleyman: Karagöz.⁵

Şükrü Zeynullah: Karagöz. E kam themeluar kur ende ishte duke shkuar në shkollë në shqip, në fshehtësi në shtëpi. E kam themeluar për fëmijë në gjuhën tonë. Për shembull, tregimet e Nasradin

⁵ *Hacivat* dhe *Karagöz* janë emrat e dy personazheve në një shfaqje të organizuar në traditën e teatrit në bez. Teatri është emëruar pas këtyre dy personazheve.

Hoxhës⁶ në vitin '48. Kur isha fëmijë, shumë fëmijë shkonin dhe shikonin dhe u kthenin shtëpi në mbrëmje. E renovuam një hangar, dyshemeja e re, dritare të reja, kanë shikuar aty.

Ebru Süleyman: Pra, ke qenë në shkollë deri në vitin '63. Ke qenë drejtor, mësues, çfarë ndodhi pastaj?

Şükrü Zeynullah: Prit, a thashë deri në vitin '63?

Ebru Süleyman: Po.

Şükrü Zeynullah: S'e di. Kur kishte mjaft mësues, mësues turk, kam shkuar në Univesitetin e Beogradit për të i përfunduar studimet. Atje kam qëndruar katër vite.

Ebru Süleyman: Kur ke shkuar atje?

Şükrü Zeynullah: Mendoj në vitin '60-'59. Kam diplomuar në vitin '63.

Ebru Süleyman: Pra keni studiuar në Beograd.

Şükrü Zeynullah: Në Beograd por edhe në Novi Sad.

Ebru Süleyman: Keni studiuar edhe në Novi Sad, çfarë keni studiuar?

Şükrü Zeynullah: Biologji, kimi, edukatë fizike, nuk kisha zgjidhje. Nuk kishim mësues në biologji, kimi, edukatë fizike prandaj më është dashur të studioj (e pakupt). Megjithatë, do të më kishte pëlqyer të studioj gjeografi ose histori ose diçka. Si të gjithë ne.

Pastaj e themelova gazetën për fëmijë me emrin ABC. Pastaj, pasi shkollat kishin mjaft mësues u emërova menaxher i Qendrës së Pionerëve, Qendrës së Pionerëve. Aty e themelova Klubin e Fëmijëve të Kombeve të Bashkuara. Qëndron edhe sot. Fëmijët ishin aty...

Ebru Süleyman: Përfaqësues të vendeve të Kombeve të Bashkuara.

Şükrü Zeynullah: Si i kanë thënë? Ambasador. A thonë ambasador? Ka pasur [përfaqësues] të Serbisë, Ruisë, Shqipërisë.

Ebru Süleyman: Vendet e Kombeve të Bashkuara.

⁶ Nasreddin ose Nasredin Hoxha ishte një satirist Seljuq, i lindur në fshatin Hortu në Sivrihisar, provinca e Eskişehir, në Turqinë e sotme dhe ka vdekur në shekullin e XIII në Akşehir. Ai konsiderohet një filozof popullor, Sufi dhe njeri i mençur, që mbahet n'mend për ankedota dhe tregimet e tij qesharake.

Şükrü Zeynullah: Sekretari i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara erdhi nga Nju Jorku zyrtarisht vetëm për të na parë. Ata i bënë provimet atje.

Ebru Süleyman: Në cilin vit?

Şükrü Zeynullah: Cilin vit... E kam një fotografi, por në cilin vit, në vitin '50-'60. Ishte U Thant⁷. U Thant?

Ebru Süleyman: Po, U Thant.

Şükrü Zeynullah: Keni dëgjuar për U Thant?

Ebru Süleyman: Po kam dëgjuar, kam dëgjuar.

Şükrü Zeynullah: U Thant, kemi fotografi, ishte punë e madhe atëherë.

Ebru Süleyman: Pra, erdhi në Prishtinë.

Şükrü Zeynullah: Cili sekretar i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara tjetër erdhi në Prishtinë? Vetëm për shkak të zyrtarit të Klubit të Fëmijëve të Kombeve të Bashkuara, një sekretar i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara erdhi në Prishtinë. Dhe fëmijët ishin në uniforma, duke i kaluar provimet, duke u bërë ambasadorë

Ebru Süleyman: Si e keni bërë krijimin e këtij klubi?

Şükrü Zeynullah: Si? Ishte detyra ime. Si më është kujtuar krijimi i korit? Së pari e kam formuar korin turk. Si më është kujtuar të formoj gazetën e fëmijëve? E kam bërë. Njëjtë me Qendrën e Pionerëve. Qendrën e Pionerëve, a e kupton? E formuam ABC-në, e kemi publikuar gazetën. Gazetën e parë, pastaj doli *Tan*⁸. Më dërguan në *Tan*, u bëra menaxher aty, menaxhues i tregtisë. Kam sjellur libra nga Turqia me kamionetë. Kam sjellur libra nga Turqia, plish, e çka jo, novela, atlase; atlasë të biologjisë, historisë, gjeografisë në gjuhën turke. Nuk kishim libra. Kur i kemi hapur shkollat nuk kishim asnjë libër, asgjë. I kemi sjellur nga atje, edhe më herët kemi...

Ebru Süleyman: Si ka qenë në *Tan* atë kohë? Mendoj që të gjithë intelektualët janë mbledhur në *Tan* atë kohë, qytetarët, njerëzit nga Prishtina.

⁷ U Thant (1909–1974), i njohur me titull nderimi si U Thant, ishte diplomat burmez dhe sekretari i përgjithshëm i tretë i Kombeve të Bashkuara nga viti 1961 deri në vitin 1971, i pari jo europian që mbajti këtë pozicion. Ai mbajti zyrën me një rekord prej dhjetë vjetësh.

⁸ *Tan*, do të thotë “agim”, ishte gazeta e parë në gjuhën turke në Kosovë që filloi botimin më 1 maj, 1969 dhe u mbyll në vitin 1992.

Şükrü Zeynullah: Kam punuar edhe në *Tan*.

Ebru Süleyman: Po, keni punuar aty. Si ishte *Tan*? Çfarë keni bërë? Atëherë ishte më aktive, apo?

Şükrü Zeynullah: Ishte e mrekullueshme, e mrekullueshme. Ishim shumë mirë dhe po e prodhonim një gazetë që edhe gazetarët nga *Birlik*⁹ na kishin lakmi. Imagjinoni ne u befasuam kur i ndjeri Necati Zekeriya erdhi në *Tan*, erdhi nga Shkupi në *Tan*. Por para se të fillonte *Tan*, para se të ndodhte *Tan* ne kishim njerëz nga Shkupi. Për shembull, kishim Naim Şaban, Nusret Dişo në *Birlik*, megjithatë, njerëzit si Necati Zekeriya, pastaj erdhi Hasan Mercan, i kemi mbledhur të gjithë. Kemi hapur pika të shitjes gjithkund, edhe në fshate. Përfaqësitë e gazetës *Tan*, kemi hapur një librari në Prizren. E kemi bërë, jo një galeri por nuk më kujtohet {pauzon të mendohet}. Kur bënë një panair, panair të librit. Në serbisht i thone *sajam* [panair] më duket. Si është në shqip?

Ebru Süleyman: Nuk e di.

Şükrü Zeynullah: Libra, njerëzit vinin dhe i shikonin librat. Ishte si galeri, galeri.

Ebru Süleyman: Po.

Şükrü Zeynullah: Galeri e madhe. Galeria është diçka tjetër por një galeri e madhe. Ata libra që i sollëm nga Turkia, i ekspozuam në Gjilan, për shembull, njerëzit nga Gjilani i blinin ata libra. Shumë lirë, simbolike [shuma e parave]. Më kujtohet espozita në Gjilan, kishte shumë njerëz, ata i shikonin dhe i blinin ato libra.

Ebru Süleyman: Ishte *Tan* në atë kohë...

Şükrü Zeynullah: Ishte *Tan* në atë kohë...

Ebru Süleyman: A kishte edhe gazeta tjera? A mund të na tregosh për to?

Şükrü Zeynullah: Jo, jo. Ishte vetëm *Tan* një vend si kabinë. Ndërtesa e gazetës nuk ka ekzistuar atëherë.

Ebru Süleyman: Ndërtesa e gazetës.

Şükrü Zeynullah: Jo, ishte *Rilindja* aty.

Ebru Süleyman: Ku ishte *Tan* në fillim?

⁹ *Birlik* ishte gazeta turke e asaj kohe në Maqedoni.

Şükrü Zeynullah: *Tan* ishte, si të them, nuk më kujtohet... e di ku ishte Komiteti?

Ebru Süleyman: Po.

Şükrü Zeynullah: Ishte mbrapa saj, ngjitur me Komitetin. Ndërtesë e madhe. Tani, siç e dini, sheshi është aty.

Ebru Süleyman: Oh, po.

Şükrü Zeynullah: E di atë ndërtesën e madhe, kasollet menjëherë pas saj, është ende aty.

Ebru Süleyman: Ende aty.

Şükrü Zeynullah: *Tan* ishte aty. Megjithatë, kur ajo ndërtesa *Rilindja* u ndërtua edhe *Tan* u zhvendos aty. U zhvendos aty.

Ebru Süleyman: U zhvendosët atje. Do të thotë tri gazeta ishin atje.

Şükrü Zeynullah: Tri gazeta, *Rilindja* më e fuqishmja. Po.

Ebru Süleyman: Axha Şuçri, kur ishit fëmijë, kur ishit i vogël, si e keni kalur kohën në qytet? Çfarë keni bërë?

Şükrü Zeynullah: Në qytet, në qytet, ne vazhdimisht mendonim për të krijuar gjëra, për të bërë diçka, për të krijuar diçka. Ne gjithashtu donim të dilnim për rekreacion, kishte shumë vende në Prishtinë. Për shembull, a kë dëgjuar për Sofalinë, Sofalia. A e din ku është Sofalia?

Ebru Süleyman: Jo, nuk e di.

Şükrü Zeynullah: *Sefali-yer* [Vend për argëtim], Sofalia.

Ebru Süleyman: Keni shkuar atje.

Şükrü Zeynullah: *Sefali-yer*. Të rinjëve ju pëlqente shumë ai vend. Sidoqoftë, burrat, të moshuarit shkonin në Taukbahçe, ishte më afër. Ishte një shatërvan aty, dy-tri vite më parë... kishte një shatërvan në Sofali që i bënte të gjithë ziliqar për bukurinë e tij. Ai gur i gjelbërt, ajo grykë e zbukurar, pellgu prej druri i gdhendur bukur, pemë zbukuruesë dhe pemë më fruta. Menzi pritje të shkoje dhe ta kaloje ditën atje. Kishte shumë vende të mira rekreative. Jo vetëm Gërmia por edhe zona e *Sıktaş*. Ishte Taslixhja, gjithashtu kishte vreshta, vreshta edhe në *Sıktaş*. Ishte një minierë guri në Gërmi, ende është aty.

Të gjitha xhamitë, ndërtesat e ushtrisë u ndërtuan nga ata gurë pas Osmanëve. Xhamitë osë Kishat ose diçka, është ende një minierë guri në Gërmi, por vreshtat drejtë kësaj rruge. Prishtina është shumë e vlefshme dhe shumë e madhe. Ka pasur shumë kafshë të rrezikshme, të egra në Gërmi, arinjë, derra të egër. Kishte disa maca; ato ngjiteshin në pemë dhe *hop* {onomatope} kërcenin mbi ty. Të friksonin por nuk ishin të rrezikshme, vetëm maca të egra.

Çfarë mund të them tjetër. Kur erdhën osmanët... pse thashë Pernandoria Romake nuk e formoi marrëveshje këtu, ku e bënë? E bënë në Ulpianë, njëzet kilometra më larg. Ata e krijuan Ulpianën. Pse nuk e bënë të tjerët? Ata u deshën të bëjnë kufinjë, keshjtella, mure më kilometra të gjata kundër pushtimeve të armikut dhe kundër kafshëve të erga. Por çfarë u bënë osmanët atyre kafshëve të egra? Zgjuarsi e mrekullueshme! Shkuan aty ku ishin gjarpërinjët e egër dhe u'a morrën të sapolindurit dhe i sollën ne shtëpi menjëherë pas luftës. U dhanë gjarpërinjët çdo të tretës apo të katërtës shtëpi me rend. Ata bënë disa si sirtar afër puseve të tyre. Gjarpëri rritej aty, ka ujë aty. Kur rritej, ushtarët osman, zyrtarët e kthenin aty prej ku e kanë marrur.

Gjithashtu edhe ujqit, kishte shumë ujq. Merrnin ujq të vegjël dhe i zbutnin dhe i kthenin. Ata ujq rritenin dhe ujqit nuk i sulmonin njerëzit më. Prandaj, ju betohem që gjatë tërë asaj kohe asnjë pikë gjaku nuk është derdhur nga sulmet nga ato kafshë të egra. Kishte shumë kafshë të egra, për shkak të ndërhyrjes së ushtarëve osman.

Kur dimrat ishin të gjatë dhe të ftoftë, ata ujq uritëshin dhe vinin hanin ushqim nga dritaret e njerëzve të shtëpive në rendin e parë te Gërmia, te lagjja te Kisha. Ata i hapnin dritaret dhe i futnin ujqit mrenda që të mos ngriheshin i ushqenin, dhe ujqit ktheheshin. Te gjithë ujqit janë zbutur. Ato maca të egra, ata gjarpërinjë nuk kafshonin njerëzit më. Jam ulur afër një gjarpëri të madh për disa orë. Ju betohem që kam ndenjur afër tij, kam lëvizur nga një anë në tjetrën, ai vetëm me shikonte dhe unë e shikoja atë. Ishte kaq i trashë {tregon me duar}, i mbëshjellur si me tabak. U ula pranë tij, po më shikonte edhe une po e shikoja në Gërmi.

Ebru Süleyman: Axha Şuçri të kthehmi në të tashmen. Të kujtohet kur trazirat filluan, politikat rreth të 1970-tave, '80-ve kur filluan protestat? Ato dy dekata para luftës, kur ajo rrëmujë po ndodhte, të kujtohet ajo? Si ishte atmosfera në qytet, çfarë po ndodhte?

Şükrü Zeynullah: A është kjo në të '60-tat?

Ebru Süleyman: Jo, në të '70-tat, të '80-tat.

Şükrü Zeynullah: Oh, jo nuk isha këtu. Kam shkuar te nëna ime, ajo u sëmur, kam jetuar aty rreth 20 vite.

Ebru Süleyman: Ke jetuar me nënën për 20 vjet.

Şükrü Zeynullah: Kam jetuar me të.

Ebru Süleyman: Kur jeni kthyer këtu?

Şükrü Zeynullah: Jam kthyer pas 17 vjetësh.

Ebru Süleyman: Pra pas luftës.

Şükrü Zeynullah: Pas luftës. Prandaj nuk di mjetueshëm që të tregoj për atë gjendje, atë situatë. Edhe pse kemi dëgjuar, e kemi ditur por...

Ebru Süleyman: Nuk ke qenë këtu.

Şükrü Zeynullah: Isha i lidhur në Turqi me, i kanë botuar shumicën e shkrimeve të mia në Ankara. Për shembull, ishte një revistë *Balkanlar*, apo?

Ebru Süleyman: Po.

Şükrü Zeynullah: Ajo në Ankara.

Ebru Süleyman: Po.

Şükrü Zeynullah: Çfarëdo që iu kam dërguar, poezi të miat, shkrimet e mia, i kanë botuar të gjitha. Nuk më kanë refuzuar kurrë. Para disa ditësh e shkruva një poezi... nuk e di nëse po ndihmoja pak apo jo?

Ebru Süleyman: Po, ishte shumë ndihmues.

Şükrü Zeynullah: Pak e rrëmujshe. Si nuk e kam ditur, pendohem shumë që nuk i kam listuar këto. Kur më the...

Ebru Süleyman: Për gjërat që doja të pyesja?

Şükrü Zeynullah: Është rendi, para se të vije, doja të i vija të gjitha në rend, të bëj një listë. Do ta përfundonim më shpejtë dhe ndoshta më mirë. Mos harro t'a përshendesësh babain tënd.

Ebru Süleyman: Falemnderit.

Şükrü Zeynullah: Ka qenë shok i imi. Edhe atij i kam pëlqyer. Por nuk kemi pasur kohë të bisedojmë. I kam pasur disa shokë, sidoqoftë. Kur kam shkuar në ushtri i kam bërë vetëm dhjetë muaj, ishte ashtu për të diplomuarit. Në vend se të bëja njëmbëdhjetë muaj, nuk merrja pushim sepse ishte larg. Ishin shtatë njerëz nga Gjilani aty.

Ebru Süleyman: Në ushtri. Ku keni shërbyer?

Şükrü Zeynullah: Sinj, Sinj. Është gjithashtu emër turk për Dalmacinë. Sinj, keni dëgjuar për të. Ishte Drnić, qyteti Drnić, ishte gjithashtu afër. Ishte në kohën e Turqisë, dervishët ishin aty, manastiret e dervishëve, por i thonë Drnić tani. Dervish. Turqit në Kroaci. Kam parë shenja turke gjithkund në Kroaci përgjatë vijës bregdetare. Atëherë Dubrovniku gjithashtu ju takonte turqve, Turqisë. Por e bënë Republikën e Dubrovnikut, u bë Republika e Dubrovikut, a kuptoni? Ushtarët po e ruanin farmacinë atje. Farmacia e parë në Evropë hapet në Dubrovnik prandaj ushtarët e ruajnë nga plaçkitjet e barnave. Prapë osmanët po kujdeseshin për atë vend. Ishte kështu. Çfarë mund të bëjë, shpresoj këto të jenë të dobishme.

Ebru Süleyman: Faleminderit shumë, shumë faleminderit për bisedën.

Şükrü Zeynullah: Të kam lodhur edhe ty? Je lodhur duke më dëgjuar. Edhe ti nuk ke kuptuar [i drejtohet kameramanës]. Duhet ta dish, një gjuhë është një person. E dini që ka zyrtarisht tre mijë fjalë turke në shqip. Këngët më të bukura shqipe, këngë të njohura shqipe, këngë dashurie janë bërë gjatë kohës turke. Sot ato nuk këndohen, pse? Çdo e dyta ose çdo e treta fjalë është turqisht, i kanë larguar. A mund ta imagjini? E gjithë bota i këndon këto melodi, por shqiptarët, krijuesit, nuk i këndojnë. Radio e Shqipërisë i lëshon, po jo ajo e Kosovës, pse? Sepse ka disa fjalë turke.

Mos e bëni këtë, nuk është asnjë më i afërm se turqët. As turqit nuk e kanë askënd me aftër se shqiptarët (e pakupt.). Me fe, me çdo gjë, e di. Për shembull, “*Gjemb mbi gjemb këndon bylbyli*”. [Në shqip]. A e keni dëgjuar këtë këngë? Jo. “*Vaj si kenka bo dynjaja*” [Në shqip] Dynja do të thotë botë. “*Vaj si kenka bo bota*”. Nuk tingëllon mirë, e prishë nëse e përkthen. “*Mos lufto boll me kanëë gjallë, punon njeri fukaraja paska ndodhur pa igball*” [Në shqip]. Ose thënja tjetër (e pakupt.). Ajo këngë të bënë për të qarë. Ose *Karanfili që ka Shkodra, me ditë sa t’bukra janë*” [Në shqip]. Nuk i dëgjon këto këngë më, është shumë keq, më pëlqejnë. Nëse e lëshon [radion] e Shqipërisë i dëgjon. Shiko çfarë gabime bëjmë. Kënga nga Shqipëria, i kemi kokat kështu {tregon me duar}.